

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJJIN “PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (KËSHILLI I MINISTRAVE) DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, PËR PROGRAMIN E SHKËMBIMIT AKADEMIK “FULBRIGHT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për programin e shkëmbimit akademik “*Fulbright*”.

Me anë të këtij memorandum mirëkuptimi, qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës bien dakord për zbatimin e programit të shkëmbimit akademik “*Fulbright*” në arsim, kulturë, shkencë dhe kërkim me qëllim realizimin e përfitimeve të ndërsjella ndërmjet palëve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është hartuar në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky memorandum mirëkuptimi synon nxitjen e mirëkuptimit e të miqësisë së ndërsjellë ndërmjet dy kombeve nëpërmjet programit të shkëmbimit akademik “*Fulbright*” në institucionet arsimore, shkencore dhe kërkimore në të dyja vendet nënshkruese të memorandumit të mirëkuptimit. Po ashtu, inkurajon bashkëpunimin në kuadër të përmirësimit të kualifikimeve të studentëve, personelit akademik, profesionistëve, për nxitjen e mëtijshme të projekteve të përbashkëta në fushat e përfshira në memorandum.

Ky memorandum mirëkuptimi vjen si iniciativë e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë, iniciativë e cila ka filluar në fund të vitit 2000 (me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, sipas emërimit të kohës) dhe u rishikua në vitet 2016-2017. Ky memorandum është bazuar në modelin e memorandumit të

mirëkuptimit të nënshkruar nga Republika e Kosovës dhe është paraqitur më pas në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për shqyrtim dhe vlerësim. Në komunikimet zyrtare ndërmjet Ministrisë dhe Ambasadës është bërë me dije se ka pasur vështirësi në lidhje me gjetjen e kuadrit ligjor në fuqi për të mbështetur bashkëpunimin financiar për programin *J. William Fulbright*.

Në vitin 2018, Floreta Luli Faber, Ambasadore e Republikës së Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara u takua me znj. Marie Royce, ndihmësekreteare për çështjet arsimore dhe kulturore, për të diskutuar zgjerimin dhe rritjen e programit të shkëmbimit akademik dhe kulturor ndërmjet dy vendeve. Ambasadorja Faber sugjeroi nënshkrimin e një memorandumit mirëkuptimi. Ajo e diskutoi këtë propozim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Në mars të vitit 2019, përfaqësuesit e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme bashkëpunuan me Zyrën për Çështje Publike pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë për të diskutuar mbi mënyrën e ndjekjes së kësaj iniciative, nxitjen e mirëkuptimit dhe miqësisë së ndërsjellë ndërmjet dy kombeve nëpërmjet programit të shkëmbimit akademik "*Fulbright*" në institucionet arsimore, shkencore dhe kërkimore në të dyja vendet nënshkruese të memorandumit, deri në miratimin e saj.

Programi "*Fulbright*" u themelua në vitin 1945 dhe mbështet shkëmbimet arsimore që forcojnë mirëkuptimin dhe komunikimin mes Shteteve të Bashkuara dhe mbi 155 vendeve në mbarë botën dhe është një formë efektive e prestigjioze e diplomacisë publike. Që nga fillimi i tij, programi "*Fulbright*" ka nxitur marrëdhëniet dypalëshe në të cilat shtetet dhe qeveritë e tjera punojnë me Shtetet e Bashkuara për të vendosur prioritetet e përbashkëta dhe për të formësuar programin për të përmbushur nevojat e përbashkëta.

Programi "*Fulbright*" ka siguruar më shumë se 286 000 pjesëmarrës, të zgjedhur për potencialin e tyre, me mundësinë për të vëzhguar institucionet politike, ekonomike dhe kulturore të njëri-tjetrit, për të shkëmbyer ide dhe për të ndërmarrë projekte të përbashkëta me rëndësi për mirëqenien e përgjithshme. Që nga themelimi i programit, më shumë se 46 000 studentë nga Shtetet e Bashkuara dhe 150 000 studentë nga vendet e tjera kanë përfituar nga përvoja "*Fulbright*".

Si një mbështetës i përpjekjeve të diplomacisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, programi i studentëve të huaj "*Fulbright*" sjell qytetarë të vendeve të tjera në Shtetet e Bashkuara për studime "Master". Ky studim zhvillohet në universitetet e SHBA-ve ose në institucione të tjera të përshtatshme. Programi ka sjellë disa nga "*mendjet më të mira*" të botës në kampuset e SHBA-ve dhe ofron njohuri të pjesëmarrësve të programit në shoqërinë dhe vlerat e SHBA-ve.

Shumë prej grandeve të huaja "*Fulbright*" janë për profesionistë të rinj në karrierë, të cilët do të kthehen më pas për të kontribuar në vendet e tyre, shpesh duke punuar në universitete ose në administratën publike.

Më shumë se 1 800 studentë të rinj “*Fulbright*” të huaj marrin pjesë në programet akademike në SHBA çdo vit. Studentët e huaj aplikojnë për programin “*Fulbright*” *Felloëships* përmes Komisionit *Fulbright/Foundation* ose Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në vendet e tyre. Instituti i Edukimit Ndërkombëtar (IIE) organizon vendosjen akademike për shumicën e kandidatëve pjesëmarrës të “*Fulbright*” dhe mbikëqyr pjesëmarrësit gjatë qëndrimit të tyre në Shtetet e Bashkuara.

Programi “*Fulbright*” për studentët të huaj është një program një- ose dyvjeçar për profesionistë të rinj dhe ata që kanë përfunduar studimet, të interesuar të ndjekin studime në nivelin “Master” në Shtetet e Bashkuara. Në bazë të një procesi të hapur konkurrimi, bursat u jepen kandidatëve që shfaqin potencial të lartë për të shërbyer me përkushtim si në sektorin publik dhe atë privat, si edhe potencial për të sjellë një qasje pozitive në të ardhmen e Shqipërisë. Bursat zakonisht zgjasin një deri në dy vjet në një universitet në Shtetet e Bashkuara për të ndjekur studime për “Master”. Kandidatët janë të detyruar të kthehen në Shqipëri për të paktën 2 (dy) vjet në përfundim të programit. Me anë të këtij memorandumi mirëkuptimi, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të mbështesë nga ana financiare programin e shkëmbimit akademik “*Fulbright Student*” për të krijuar mundësi të tjera shtesë për studentët, në mënyrë që të bëhen pjesë e këtij programi.

Programi “*Fulbright*” për studiues të huaj është një program që u jep mundësi studiuesve të rinj apo me më shumë përvojë, lektorëve të universitetit dhe ekspertëve nga institucione akademike dhe kërkimi të bëjnë kërkime dhe/ose të japin mësim në një universitet në Shtetet e Bashkuara. Në bazë të një procesi të hapur konkurrimi, bursat u jepen kandidatëve që shfaqin më së miri përkushtim në detyrë, si në sektorin publik dhe atë privat, si dhe potencial për të sjellë një qasje pozitive në të ardhmen e Shqipërisë. Bursat zakonisht zgjasin tre deri në gjashtë muaj në një universitet në Shtetet e Bashkuara. Kandidatët janë të detyruar të kthehen në Shqipëri për të paktën 2 (dy) vjet në përfundim të programit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE ARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në përputhje me nenin 78, nenin 83, pika 1 dhe nenin 121, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk parashikon përafrim me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për programin e shkëmbimit akademik “*Fulbright*”, në bazë të përcaktimeve të nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se ratifikimi është akti, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar më parë prej saj.

Në bazë të këtij neni, ministria kompetente i paraqet për shqyrtim Këshillit të Ministrave, brenda 30 ditëve pune nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, (ky memorandum është nënshkruar në datën 25 shtator 2019) propozimin për ratifikimin e marrëveshjes, të shoqëruar nga dokumentet e mëposhtme:

- a) Projektligjin për ratifikim;
- b) Projektvendimin për propozimin e projektligjit;
- c) Vendimin e miratimit në parim;
- ç) Tekstet e marrëveshjes së nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze ose përkthimin e certifikuar, në mungesë të nënshkrimit në gjuhën shqipe;
- d) Relacionin shpjegues, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji;
- dh) Mendimin e Ministrisë për Evropën për Punët e Jashtme dhe i Ministrisë së Drejtësisë për përmbajtjen e projektligjit.

Me anë të këtij memorandumi mirëkuptimi, të nënshkruar nga qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe qeveria e Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave), synohet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve arsimore, shkencore dhe kërkimore të të dyja palëve nënshkruese me qëllim realizimin e përfitimeve të ndërsjella ndërmjet tyre.

Pala e Shteteve të Bashkuara të Amerikës do të koordinojë menaxhimin e programit “*Fulbright*” në Republikën e Shqipërisë, organizimin e përzgjedhjes fillestare të kandidatëve si dhe zhvillimin e aktiviteteve mësimore-shkencore dhe analizimin e potencialit për shkëmbime akademike shtesë. Përzgjedhja do të jetë e bazuar në parimin e meritës dhe do të bëhet në përputhje me kriteret e vendosura nga Bordi i Bursave të Huaja J. William “*Fulbright*” të Shteteve të Bashkuara. Këto kriteret mund të specifikohen nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, në përputhje me politikat e programit.

Koordinatori i këtij memorandumi mirëkuptimi, në emër të qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, do të jetë Seksioni i Punëve Publike të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë dhe në emër të Këshillit të

Ministrave të Republikës së Shqipërisë do të jetë Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Me anë të këtij memorandumi mirëkuptimi synohet që çdo vit të përzgjidhen studentë, personel akademik dhe profesionistë nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të Republikës së Shqipërisë për të studiuar në universitetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe të koordinohet dërgimi i studentëve, personelit akademik dhe profesionistëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në institucionet akademike apo institucionet e tjera të Republikës së Shqipërisë për studime, kërkime apo stazhe akademike. Pala shqiptare do të ketë përfaqësues në komisionin përzgjedhës pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë për të përzgjedhur studentët, personelin akademik dhe profesionistët që do të marrin pjesë në programin “*Fulbright*”.

Pala shqiptare do të ofrojë mbështetje financiare në shumën prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) euro në vit, nëpërmjet fondit të bursave të ekselencës, për të mbështetur kostot e programit “*Fulbright Student*” me qëllim krijimin e më shumë mundësive për studentët, personelin akademik dhe profesionistët që marrin pjesë në këtë program. Kontributi do të paguhet duke filluar nga viti akademik 2019-2020 deri në vitin akademik 2024-2025, ndërsa pranimi të fillojë nga viti akademik 2020-2021 dhe në vijim.

Pjesëmarrësi shqiptar mund të konsiderojë bashkëpunimin me pjesëmarrësin e SHBA-ve përmes ndarjes së burimeve shtesë ndërmjet fondit të bursave të ekselencës në Republikën e Shqipërisë për studentët e Shqipërisë në fushat me interes të veçantë për Shqipërinë.

Gjatë zbatimit të këtij memorandumi, palët pjesëmarrëse planifikojnë të shkëmbejnë informacion rreth pjesëmarrjes të institucioneve arsimore, kulturore, shkencore dhe kërkimore në programin “*Fulbright*” për dhënien e përparësive nevojave arsimore, kulturore, shkencore dhe kërkimore të këtyre institucioneve.

Gjatë zbatimit të këtij memorandumi, pala shqiptare synon të nxisë institucionet qeveritare, arsimore, kulturore, shkencore, kërkimore që të mundësojnë kushtet më të favorshme të mundshme për zbatimin e programit “*Fulbright*” në Republikën e Shqipërisë.

Pala shqiptare synon të koordinojë aprovimin në kohën e duhur dhe lëshimin e dokumenteve ligjore të nevojshme për studentët, personelin akademik dhe profesionistët, për pjesëmarrjen në programin “*Fulbright*” në Republikën e Shqipërisë.

Palët shkëmbejnë informacion dhe planifikojnë rreth pjesëmarrjes së institucioneve arsimore, kulturore, shkencore dhe kërkimore duke i dhënë përparësi nevojave të tyre, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi.

Memorandumi përmban edhe hyrjen në fuqi të tij, e cila fillon pas njoftimit të pjesëmarrësve nga autoritetet kompetente për përfundimin e të gjitha procedurave të nevojshme të brendshme dhe të vijoje për një periudhë 5-vjeçare.

Ky memorandum mirëkuptimi mund të modifikohet me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të të dy palëve.

Ky memorandum mirëkuptimi mund të ndërpritet në çdo kohë nga njëra prej palëve pjesëmarrëse duke informuar palën tjetër me shkrim. Pjesëmarrësi i cili dëshiron të ndërpresë memorandumin, duhet të njoftojë me shkrim pjesëmarrësin tjetër të paktën 12 (dymbëdhjetë) muaj para mbi qëllimin e tij për të ndërprerë bashkëpunimin.

Ky projektligj nuk i nënshtrohet procedurës së kryerjes së vlerësimit të ndikimit (RIA), pasi në bazë të shkronjës “c”, të pikës 45/1, të vendimit nr.584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar, *përfshihen nga detyrimi i kryerjes së vlerësimit të ndikimit projektaktet që lidhen me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomatike, veçanërisht ratifikime të marrëveshjeve ndërkombëtare apo çështje që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare.*

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Për hartimin e këtij projektakti ka kontribuar Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Gjatë fazës së negocimit të memorandumit të mirëkuptimit, projektakti është rakorduar edhe me përfaqësues të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektakti do të sjellë efekte financiare në shumën prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) eurosh, të cilat do të mbulohen nga buxheti i shtetit, për të mbështetur kostot e programit “*Fulbright Student*”, me qëllim krijimin e më shumë mundësive për studentë, personel akademik dhe profesionistë që marrin pjesë në programin “*Fulbright*”.

KËSHILLI I MINISTRAVE